

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.


Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrimit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit tetor, 2025

Finalizohet projektligji “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”

3.10.2025: Procesi për hartimin e projektligjit të ri “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” ka hyrë në fazën përmbyllëse. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, në bashkëpunim me ILDKPKI, në cilësinë e autoritetit publik, përgjegjës për zbatimin e ligjit diskutuan në një tryezë të hapur konsultimi publik, përmbajtjen e projektligjit “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Përfaqësues nga institucionet publike, në nivel qendror dhe të varësisë, komuniteti i biznesit, shoqëria civile dhe përfaqësues nga akademia morën në shqyrtim parashikimet e projektligjit mbi mekanizmat e mbrojtjes së sinjalizuesve, garantimin e konfidencialitetit dhe mënyrën e funksionimit të kanaleve të brendshme dhe të jashtme të raportimit. Projektligji pritet të krijojë një mjedis të sigurt dhe të besueshëm për individët që raportojnë shkelje, ndërsa kontribuon drejtpërdrejt në forcimin e sundimit të ligjit dhe avancimin e procesit të integritetit evropian. Projektligji është pjesë e paketës ligjore “Antikorrupsioni”, tashmë në pritje për miratim nga Këshilli i Ministrave dhe në vijim nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.




Shpallet për konsultim publik projektligji “Për lobimin”

24.10.2025: Shpallet në konsultim publik projektligji “Për lobimin”, një nismë e re ligjore që synon të plotësojë kuadrin kombëtar në fushën e luftës kundër korrupsionit dhe të përmirësojë standardet e transparencës dhe llogaridhënies në proceset vendimmarrëse. Projektligji ka për qëllim formalizimin dhe rregullimin e veprimtarisë së lobimit në Shqipëri, duke e kthyer atë në një proces të ligjshëm, transparent dhe të kontrollueshëm, me rregulla të qarta dhe detyrime të përcaktuara për raportim dhe mbikëqyrje. Hartimi i projektligjit është realizuar nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në cilësinë e kryesuesit të grupit ndërinstitutional hartues, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në ushtrim të funksioneve të Sekretariatit Teknik të grupit, duke përgatitur analizën paraprake, koordinuar procesin ndërinstitutional dhe hartuar tekstin përfundimtar të projektligjit në bashkëpunim me ekspertët e Këshillit të Evropës.

Projektligji“Për lobimin”mund të aksesohet në link:
<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/890>

Nga masat tek rezultatet; mbyllet raportimi për strategjinë antikorrupsion, janar-qershor 2025

10.10.2025: Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit, për periudhën janar-qershor 2025 kanë shënuar një zbatim të qëndrueshëm. Në takimin e Ekipit Tematik Teknik Antikorrupsion, të zhvilluar përmes platformës *Microsoft Teams* u prezantua draftreporti final i monitorimit për këtë periudhë me pjesëmarrjen e anëtarëve të Rrjetit të Pikave të Kontaktit Antikorrupsion, përfaqësues të të gjithë institucioneve zbatuese në strategji. Niveli i përgjithshëm i zbatimit për masat dhe aktivitetet e periudhës së përmendur (43 masa/107 aktivitete) rezultojnë të jetë në masën 71.3%. Më konkretisht, nga vlerësimi i kryer janë 25 masa/64 aktivitete të zbatuara, 15 masa/21 aktivitete në status pjesërisht të zbatuara dhe 3 masa/2 aktivitete të pazbatuara. Disa arritje konkrete të mira përmenden ato referuar parandalimit të korrupsionit përmes inicimit të përgatitjes së nismave ligjore (paketa ligjore antikorrupsion), konsolidimit të kapaciteteve institucionale antikorrupsion, si dhe hartimit të metodologjisë së përgjithshme dhe sektoriale për vlerësimin e riskut të korrupsionit. Sa i takon, ndëshkimit të korrupsionit, janë evidentuar 30 raporte kontrolli dhe 17 akt-konstatime pranë institucioneve ku operon Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Prokuroria e Posaçme ka hetuar 462 procedime me 230 persona nën hetim dhe Prokuroria e Përgjithshme ka përfunduar 86 çështje. Policia e Shtetit ka kryer 9 operacione të përbashkëta me Interpol dhe Europol. Sa i takon, informimit dhe ndërgjegjësimit antikorrupsion edhe për këtë periudhë janë zhvilluar takime (orë të hapura) për etikën dhe integritetin pranë universiteteve si edhe kryer shpërndarja e e-buletinit “Antikorrupsioni”. Raporti i monitorimit pritet të miratohet nga Ekipi Tematik Antikorrupsion, drejtuar nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.



Tetor 2025; Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit propozon 13 masa disiplinore për zyrtarë publikë

1-31.10.2025: Aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në fushën e hetimit dhe verifikimit administrativ vijon me verifikimin e rasteve (ankesa/denoncime) të përcjella nga qytetarët dhe të administruara nga Drejtoria e Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ dhe Koordinatorët kundër Korrupsionit. Gjatë muajit tetor 2025, janë konkluduar 4 raporte përfundimtare për Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës mbi bazën e analizës së plotë të fakteve dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, dhe propozuar 13 masa disiplinore për titullarë, ish-titullarë dhe punonjës të institucioneve ku është kryer hetimi. Gjithashtu, nisur nga roli i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit për sa i përket parandalimit të korrupsionit, është vijuar me propozimin e rekomandimeve, të cilat bazohen në parimet e përmirësimit të qëndrueshëm të institucionit, kapaciteteve menaxhuese, ligjore, dhe teknike në përputhje të plotë me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Nëpërmjet rekomandimeve synohet ndikimi konkret në përmirësimin e problematikave sistematike, të cilat lidhen me qartësimin e praktikave të brendshme, standardizimit të procedurave në lidhje me aspektet administrative dhe organizative, forcimit të bashkëpunimit ndërinstitutional, si dhe rritjes së llogaridhënies. Në këtë kontekst, nëpërmjet 4 raporteve të këtij muaji janë propozuar 16 rekomandime të cilat në 12 raste adresojnë çështje të natyrës administrative dhe lidhen me procedura konkrete dhe në 4 raste adresojnë çështje me natyrë organizative si në lidhje me menaxhimin e përditshëm dhe procedurat e brendshme të institucionit.

UNDOC në Tiranë; fokusi në riskun e korrupsionit dhe integritetin në prokurimet publike

31.10.2025: Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në bashkëpunim me Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), zhvilluan në Tiranë një aktivitet të dedikuar progresit të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024 - 2030. Takimi shënoi një hap të rëndësishëm në forcimin e koordinimit strategjik ndërinstitutional dhe në konsolidimin e qasjes së re sektoriale të Strategjisë, të vlerësimit të riskut të korrupsionit, e cila synon të thellojë ndërhyrjet kundër korrupsionit në nivelet më të ndjeshme të administratës publike. Pjesëmarrësit, përfaqësues të institucioneve zbatuese të strategjisë, partnerëve ndërkombëtarë, shoqërisë civile dhe sektorit privat, ndanë përvoja dhe praktika mbi mënyrat konkrete për rritjen e integritetit institucional, forcimin e transparencës dhe koordinimin efektiv ndërmjet aktorëve publikë e privatë. Instrumenti i vlerësimit të riskut të korrupsionit dhe integriteti në prokurimet publike, si një nga



fushat me ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqeverisje dhe besimin e qytetarëve, patën një hapësirë të dedikuar diskutimesh. Folësit u ndalën tek rëndësia e forcimit të mekanizmave të kontrollit dhe të zbatimit të standardeve etike gjatë gjithë ciklit të vlerësimit, si mënyrë për të parandaluar abuzimet dhe për të garantuar përdorim të drejtë dhe të ndershëm të fondeve publike. Aktiviteti risolli në Tiranë, UNODC duke forcuar bashkëpunimin teknik me Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit në drejtimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë, dhe mbështetjen e vazhdueshme të UNODC në forcimin e mekanizmave kombëtarë të integritetit dhe parandalimit të korrupsionit në Shqipëri.



Agjencia Shtetërore e Kadastrës finalizon Planin e Integritetit, 2025-2027

29.10.2025: Me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsion dhe në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, u finalizua hartimi i Planit të Integritetit, 2025-2027, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Analiza e vlerësimit të riskut institucional të integritetit dhe plani i masave për ndërhyrje, u diskutuan në dy tryeza të posaçme pune dhe diskutimesh të stafit drejtues e specialistë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me grupe interesi. Noterë, përmbarues, inxhinjerë, gjeodetë, juristë të Avokaturës së Shtetit diskutuan për risqet e integritetit dhe masat parandaluese të ekspozimit ndaj korrupsionit, përcaktimin e veprimeve konkrete për përmirësimin e integritetit institucional, nëpërmjet akteve të brendshme rregullatore, miratimin e dokumenteve të punës (manualë), shtimin dhe forcimin e njohurive teknike-profesionale pranë të gjithë drejtorive teknike. Forcimi i sistemit të kontrollit të brendshëm për një menaxhim më efektiv dhe të përgjegjshëm të proceseve; Rritja e përgjegjshmërisë institucionale dhe përmirësimi i kulturës së integritetit në vendimarrje; Shtimi i besimit të qytetarëve dhe bizneseve në shërbimet publike të ofruara nga kadastra, si edhe Transparencë e shtuar istitucionale dhe përmirësim i perceptimit të besimit të publikut ndaj kadastrës janë objektivet e adresuar në këtë dokument, që pritet të zbatohet për një periudhë 3-vjeçare, me miratimin e tij me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Draftin final të Planit të Integritetit e gjeni në link: <https://www.ashk.gov.al/wp-content/uploads/2025/09/Draft-Plani-i-Integritetit-te-Agjencise-Shteterore-te-Kadastres.pdf>

Shqipëria merr statusin e “vëzhguesit” në Rrjetin e Vendeve Evropiane Kundër Korrupsionit

15.10.2025: Shqipëria merr statusin e “vëzhguesit” në Rrjetin e vendeve të Bashkimit Evropian Kundër Korrupsionit (EUAN). Në selinë e Komisionit Evropian në Bruksel u zhvillua Mbledhja e tretë Plenare e Rrjetit EUAN, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit është një prej autoriteteve qendrore shtetërore që përfaqëson vendin. Aktiviteti mbledhi autoritetet antikorrupsion të shteteve anëtare për të ndarë përvojat mbi forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, integritetin publik dhe masat parandaluese kundër korrupsionit. Gjatë sesioneve plenare u trajtuan tema kyçe si vlerësimi i riskut të korrupsionit, mbikëqyrja e lobimit, deklarimi i pasurisë dhe forcimi i mekanizmave të integritetit në administratën publike. Përfshirja e Shqipërisë në cilësinë e vëzhguesit në këtë forum evropian dëshmon angazhimin e institucioneve shqiptare për zbatimin e standardeve të BE-së në fushën e qeverisjes së mirë dhe transparencës. Pjesëmarrja e shtetit shqiptar, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, përbën një mundësi të rëndësishme për shkëmbimin e praktikave më të mira, prezantimin e reformave të ndërmarra në kuadër të Strategjisë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030, si dhe për forcimin e rrjeteve profesionale me institucionet homologe evropiane.



Qasje rajonale në parandalimin e korrupsionit; Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit prezanton përvojën shqiptare

27-29.10.2025: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit mori pjesë në Konferencën Rajonale me temë: “Parandalimi i korrupsionit: sfidat dhe qasjet rajonale antikorrupsion”, në Petrovac, Mal të Zi. Aktiviteti i organizuar nga UNODC në bashkëpunim me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit të Malit të Zi mbledhi përfaqësues të institucioneve antikorrupsion nga vendet e rajonit, organizata ndërkombëtare dhe përfaqësues të shoqërisë civile, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave për parandalimin efektiv të korrupsionit. Konferenca shërbeu si një platformë rajonale bashkëpunimi, duke mundësuar diskutime strategjike mbi sfidat, qasjet inovative dhe masat parandaluese të korrupsionit. Në fokus ishin temat që lidhen me: Progresin rajonal dhe zhvillimet kryesore në fushën e parandalimit të korrupsionit; Forcimin e integritetit institucional dhe mekanizmat parandalues; Praktikrat më të mira të vendeve të rajonit në zbatimin e strategjive antikorrupsion; Zgjidhjen e konflikteve të interesit në ushtrimin e funksioneve publike. Përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit iu bashkuan panelit mbi forcimin e integritetit dhe mekanizmat parandalues, duke prezantuar zhvillimet kryesore të Shqipërisë në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit 2024- 2030 dhe adresuar integritetin si shtyllë themelore të parandalimit në kuadër të Strategjisë; Instrumentin e Planeve të Integritetit dhe progresin e zbatimit të tyre në institucionet publike shqiptare; Procesin e vlerësimit të riskut të korrupsionit si mekanizëm parandalues praktik; Rishikimin e paketës së ligjeve antikorrupsion në funksion të përmirësimit të qeverisjes si edhe, Promovimin e kulturës së integritetit në administratën publike e shoqëri.

Nga sektori publik tek sektori privat; integriteti si standard i luftës kundër korrupsionit

24.10.2025: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit mbështet instalimin e integritetit në organizimin dhe veprimtarinë e sektorit privat (biznese dhe kompani). “Nga integriteti tek përputhshmëria” bëri bashkë edhe këtë vit sektorin publik dhe sektorin privat duke adresuar planifikimin strategjik të luftës kundër korrupsionit, 2024-2030, për më shumë integritet, ligjshmëri, veprimtari korrekte dhe masa kundër korrupsionit. Dhoma Amerikane e Tregtisë në bashkëpunim me ekspertizën teknike të orgainzatës IDM Albania u përgëzuan nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit për këtë nismë që rrit ndërgjegjësimin dhe zhvillimin e aftësive praktike për menaxhimin e risqeve të korrupsionit dhe konfliktit të interesit në kompanitë private, përmes përdorimit të instrumenteve të vetë-rregullimit si kodet e etikës, planet e integritetit dhe njësitë e sinjalizimit. Ky bashkëpunim ndërmjet sektorit publik, shoqërisë civile dhe komunitetit të biznesit, përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt jetëzimit të masave parandaluese të korrupsionit, duke e kthyer integritetin në një vlerë konkrete dhe të përditshme pune në bizneset shqiptare.

